



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:300022

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05634953

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Taholli, në çështjen penale ndaj të pandehurve Sh.I. dhe N.I. që të dy me vendbanim në Rr. "...", komuna Ferizaj, duke vendosur lidhur me marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND. ... /2024, të datës 26.04.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurve Sh.I. dhe N.I., në njërën anë dhe të dëmtuarit I.L., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.745/2023, të datës 22.12.2023, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK), në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP) dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, më datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr..../2024, e datës 26.04.2024 e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, në mes të pandehurit Sh.I., me vendbanim në Rr. "...", Komuna Ferizaj, i lindur me datë ..., me numër personal ... dhe N.I. me vendbanim në Rr. "...", Komuna Ferizaj, i lindur me datë ..., me numër personal ... në njërën anë dhe të dëmtuarit I.L. i lindur me datë ... me numër personal ... në anën tjetër.
- II. Hudhet** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 745/2023, e datës 22.12.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurve Sh.I. dhe N.I., për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së.
- III.** Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.745/2023, të datës 22.12.2023, i ka akuzuar të pandehurit Sh.I. dhe N.I., për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 1 të KPRK-së.

Më datë 18.04.2024, është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe në këtë shqyrtim fillestar bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, palët kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet përmes procedurës së ndërmjetësimit. Gjykata e ka aprovuar propozimin e palëve dhe bazuar në nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së, e ka referuar çështjen në ndërmjetësim.

Më datë 26.04.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit ND.nr. ../2024, në mes të pandehurit Sh.I., me vendbanim në Rr. "...", Komuna Ferizaj, i lindur me datë ..., me numër personal ... dhe N.I. me vendbanim në Rr. "...", Komuna Ferizaj, i lindur me datë ..., me numër personal ... në njërën anë dhe të dëmtuarit I.L. i lindur me datë ..., me numër personal ... në anën tjetër.

Andaj, gjykata duke vepruar sipas dispozitave të nenit nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së dhe nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, e aprovoi këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim KPP-në dhe me Ligjin për Ndërmjetësim, dhe kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga të gjitha të lartcekurat, e në bazë të nenit 229 paragrafi 5 të KPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2023:300023, datë 29.04.2024

Zyrtarja ligjore,

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Ardita Tasholli

Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.